



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2012

 TË DHËNAT U PËRGATITEN NGA DPPM
TIRANË, Janar 2012,

PËRMBAJTJA

I-HYRJE.....

II-DETYRAT FUNKSIONALE TË REALIZUARA SIPAS SEKTORËVE.....

1- SEKTORI I EKZAMINIMIT TË PATENTAVE DHE MODELEVE TE PERDORIMIT....

*2- SEKTORI I EKZAMINIMIT TË MARKAVE DISENJOVE DHE TREGUESVE
GJEOGRAFIKE.....*

3- SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË.....

4-SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.....

5- SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE FINANCËS.....

I. HYRJE

Në këtë raport prezantohet puna e realizuar nga personeli i DPPM-së gjatë vitit 2012.

Funksioni kryesor i punës është rregjistrimi i objekteve të Pronësisë Industriale. Në këtë kuadër gjatë këtij vitit 2012 nga sektori i markave janë lëshuar çertifikatat e regjistrimit për 1036 marka, dhe sektori i patentave janë lëshuar 351 patenta për shpikje nga të cilat 344 janë patenta Evropiane dhe 7 janë patenta kombetare. Gjithashtu në vitin 2012 janë depozituar 352 aplikime te reja për patentë, 1017 aplikime për marka dhe 25 aplikime për diseno industriale.

Gjatë vitit 2012, DPPM ka ndjekur aktivitete në fushën ndërkombëtare, si pjesmarrja në komitetet e organizuara dhe në grupet e punës të WIPO-s dhe të Organizatës Evropiane të Patentave. Ajo gjithashtu është përfshirë në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rajonal.

Në kuadër të kryerjes sa më mirë të shërbimeve të informacionit për klientët tanë, DPPM ka vendosur të publikojë informacion më të hollësishëm në faqen e saj të internetit www.alpto.gov.al, në lidhje me mënyrën e plotësimit të formularit të kërkesës për regjistrim marke (FM1) si dhe në lidhje me dokumentet që duhet të përmbajë aplikimi në momentin e depozitimit.

Një detyrë tjetër e DPPM-së për vitin 2012 ka qenë zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe përmbushja e prioriteteve të Dokumentit të Partneritetit Evropian. Këto janë ndër objektivat kryesorë strategjike të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 760 datë 01.09.2010, hyrë në fuqi më datë 8 dhjetor 2010.

Strategjia përmban një plan veprimi të ndarë në planin afatshkurtër (2010-2012) dhe planin afatgjatë (2010-2015).

Për realizimin e detyrimeve të parashikuara në strategjinë e PI dhe në PKZMSA, DPPM ka punuar në këto drejtime:

1- Zhvillimet legjislative

2- Bashkëpunimi me institucionet e përfshira në mbrojtjen e të drejtave të PI

3- Forcimi i kapaciteteve administrative te DPPM

4- Zbatimi i të drejtave të Pronësisë Industriale

5- Promovimi i të drejtave të Pronësisë Industriale.

1- Zhvillimet legjislative

Aktet ligjore të ndryshuara përfshijnë modifikime të rëndësishme që synojnë harmonizimin e plotë të legjislacionit në fushën e pronësisë industriale me *acquis*.

Gjatë vitit 2012 janë miratuar dhe ndryshuar këto akte legjislative:

- Është miratuar ligji Nr. 23/2012 datë 01.03.2012 për disa ndryshime në Kodin Penal të RSH.

Ndryshimet në Kodin Penal konsistojnë midis të tjerave, në parashikimin si vepër penale të shkeljes së të drejtave mbi objektet e Pronësisë Industriale (patentat, markat, disenjot, treguesit gjeografike, topografitë e qarqeve të integruara) në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së TRIPS-it.

- Është në përfundim hartimi i projektligjit për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i cili synon harmonizimin e plotë të legjislacionit në fushën e pronësisë industriale me këto akte të *acquis*:
 - Direktiva 98/44/EC "Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;
 - Direktiva 98/71/EC "Për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale";
 - Direktiva 2008/95/EC "Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare për markat tregtare dhe të shërbimit";
 - Direktiva 2004/48/EC "Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale"

Institucioni përgjegjës për përgatitjen e projektligjit është DPPM me asistencën e Projektit IPA Kombëtare 2009.

Për realizimin e këtij objekti, gjatë muajit **Shtator 2012**, ekspertët e përzgjedhur nga projekti IPA 2009 "Zhvillimi i sistemit të të drejtave të pronësisë industriale në Shqipëri" kanë përgatitur draftin e parë të ndryshimeve të projektligjit, duke synuar përafrimin e plotë të tij me aktet komunitare. Në datën 12 Shtator 2012 është zhvilluar një takim i përbashkët mes eksperteve të projektit IPA dhe specialistëve të DPPM ku është diskutuar drafti i paraqitur nga ekspertët. Gjatë muajve Tetor-Nëntor 2012 është finalizuar në parim drafti i ndryshimeve në anglisht dhe në muajin Dhjetor ka filluar procesi i hartimit të projektligjit së bashku me relacionin shpjegues dhe tabelat e përafrimit me *acquis* nga eksperti lokal.

Projektligji do të konsultohet me grupet e interesit dhe do të dërgohet në METE për fillimin e procedurës për marrje mendimi nga ministritë përgjegjëse brenda muajit mars 2013.

- Është hartuar projektligji për aderimin e Shqipërisë në Marrëveshjen e Londrës për Patentat Evropiane. Gjatë muajit shtator-nëntor 2012 ka përfunduar përgatitja e projektligjit si dhe konsultimi dhe marrja e mendimeve nga grupet e interesit dhe institucionet përkatëse.
- Është hartuar projektligji për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8488 datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” i cili synon harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me këto akte të acquis:
 - Direktivën Nr. 87/54 “Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara” Institucioni përgjegjës për përgatitjen e projektligjit është DPPM me asistencën e Projektit IPA Kombëtare 2009. Afati i miratimit të projektligjit është muaji Mars 2013.

Gjatë periudhës shtator-nëntor 2012 ka përfunduar hartimi i projektligjit dhe dokumentave shoqëruese të tij (relacioni, tabelat e përfrimit) nga ekspertët e përzgjedhur nga projekti IPA 2009. Gjatë muajit Nëntor-Dhjetor 2012 janë zhvilluar takime për konsultimin e projektligjit me grupet e interesit. Brenda muajit mars 2013 projektligji parashikohet të dërgohet në METE për fillimin e procedurës për marrje mendimi nga ministritë përgjegjëse dhe propozim në Këshillin e Ministrave.

2- Bashkëpunimi me institucionet e përfshira në mbrojtjen e të drejtave të PI

DPPM gjatë vitit 2012 ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës dhe Zyrën e Pronësisë Industriale të Kosovës.

Nënshkrimi i këtyre memorandumeve nxit zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e të drejtave të PI, siguron një mbrojtje efektive të këtyre të drejtave sipas standarteve ndërkombëtare, për të përfaqësuar interesat e përdoruesve në një aspekt më të gjërë, kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik duke inkurajuar punën krijuese dhe shpikjet edhe në nivel rajonal.

3- Forcimi i kapaciteteve administrative të DPPM

Sistemi IT i DPPM është përmirësuar me pajisje të reja dhe ka filluar përdorimi i një versioni të ri të përmirësuar të sistemit IPAS (Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale), për procesimin e aplikimeve për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale. Versioni i ri i sistemit IPAS i cili është instaluar me suportin teknik dhe financiar të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale përbën hapin e parë drejt krijimit të infrastrukturës së nevojshme për bërjen të aksesueshme on-line të bazës së të dhënave elektronike të DPPM nga subjektet e interesuara si dhe fillimin e pranimeve të aplikimeve on-line (e-filing). Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përmirësimin e shërbimeve online.

Pra përmirësimi i infrastrukturës së TI-së DPPM nëpërmjet blerjes dhe instalimit të softëare dhe pajisjeve, përmirësimi i sigurisë së TI, dixhitalizimi i dokumentave të regjistrimit të objekteve të PI, zhvillimi i faqes së internetit të DPPM, përmirësimi i shërbimeve on-line jep impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës të punës së DPPM-së, garanton përshpejtim të mëtejshëm të të gjitha aktiviteteve bazë të DPPM-së, veçanërisht në përpunimin e aplikimeve, monitorimin e saktësisë së të dhënave dhe rrit produktivitetin e punës.

Me mbështetjen e projektit IPA 2009, janë blerë dhe instaluar pajisje dhe softëare për rritjen e sigurisë së infrastrukturës së TI në DPPM.

Në kuadër të planit bilateral të bashkëpunimit mes Zyrës Evropiane të Patentave dhe DPPM, është parashikuar dhënia e asistencës për përmirësimin e faqes së internetit të DPPM dhe ka filluar implementimi i projektit përkatës nga ZEP.

Gjate periudhës Shtator-Nentor 2012, DPPM ka punuar në drejtim të përgatitjes së modulit të kërkimit on-line që do të mundësojë aksesimin e publikut në bazën e të dhënave të DPPM dhe kryerjen e kërkimeve në të.

DPPM ka publikuar dalë 6 buletine të objekteve të PI për markat tregtare dhe të shërbimit dhe 12 buletine për patentat e shpikjeve. Këto buletine publikohen çdo 2-muaj për markat dhe çdo muaj për patentat. Shtimi i numrit të publikimeve ka ndikuar në përshpejtimin e procedurave të regjistrimit të markave dhe patentave.

4- Zbatimi i të drejtave të Pronësisë Industriale

Në fushën e zbatimit të të drejtave DPPM ka dhënë inputin e saj në ngritjen e Inspektoriatit për mbrojtjen e të drejtave të PI që do të jetë pjesë e Inspektoriatit të Mbikqyrjes së Tregut dhe që do krijohet në varësi të METE-s.

DPPM me mbështetjen e Projektit IPA 2009 ka zhvilluar 3 seminare me gjyqtarë të përfshirë në çështjet e PI dhe 1 seminar me përfaqësues të policisë tatimore dhe të krimit ekonomik.

Trajnimi i stafit të DPPM dhe i stafit të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të Pronësisë Industriale si doganat, policia, gjykata ka qenë në qendër të punës së DPPM për vitin 2012.

Gjatë muajve shtator – nëntor 2012, në kuadër të projektit IPA 2009 janë zhvilluar aktivitetet trajnuese:

- Në datat 30-31 Maj 2012, trajnim me teme “Zhvillimi I sistemit te Pronesise Industriale”, Razëm organizuar nga Shkolla e magjistratures në bashkëpunim me projektin “Zhvillimi I sistemit të të drejtave të pronësisë industriale” në Shqipëri.
- Në datat 10-11 tetor 2012 është zhvilluar seminari “Për zbatimin e të drejtave mbi markat tregtare” me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe studentëve të Shkollës së Magjistraturës.
- Në datat 6-7 nëntor 2012 është zhvilluar seminari “Mbi administrimin e aplikimeve për patenta evropiane nga zyrat kombëtare” me pjesëmarrjen e stafit të DPPM.
- Në datat 13-14 nëntor 2012 është zhvilluar për stafin e DPPM trajnimi “Për klasifikimin ndërkombëtar të Vjenës për elementet figurative të markave”.

Trajnime dhe takime të tjera

- Në datat 9-13 Korrik 2012 Mbledhja e Komitetit mbi pronesine intelktuale dhe traditat kulturore dhe folklorin në Gjenevë.
- Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale në bashkëpunim me DPPM ka organizuar në datat 14-15 nëntor 2012 seminarin “Mbi traktatin e bashkëpunimit në fushën e patentave” me pjesëmarrjen e stafit të DPPM dhe profesionistëve në fushën e patentave.
- Në datat 21-23 Nëntor 2012 Chateau Linza Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës në bashkëpunim me institutin e trajnimeve të administratës publike (TIPA), T.M.C Asser Institute me mbështetjen e Giz GmbH organizoi një trajnim për institucionet e linjës (training of trainers) në fushën e Politikave të përbashkëta tregtare të komitetit europian (Kapitulli 30). Në trajnim u diskutua mbi ligjin e Organizatës Botërore të Tregtisë, ligjin tregtar të EU, rregullat e origjinës, etj.
- Në datat 18 Dhjetor 2012, Projekti “Zhvillimi i sistemit të të drejtave të pronësisë industriale” në Shqipëri në bashkëpunim me DPPM organizuan seminarin me temë “Treguesit gjeografikë”. Në trajnim u diskutua në lidhje me Nocionin e treguesit gjeografik dhe sistemet e mbrojtjes së tyre, Trips, marrëveshja e Lisbonës, Sistemi I BE për mbrojtjen e treguesve gjeografike për produktet bujqësore dhe ato

ushqimore, procedurat për regjistrimin e TGJ, kontrolli i karakteristikave të produkteve dhe përcaktimi i zonës gjeografike, shembull nga Franca dhe Maqedonia, treguesit gjeografike dhe markat kolektive.

- DPPM ka ndjekur aktivitete në fushën ndërkombëtare. Ato kanë marrë pjesë në komitetet e organizuara dhe në grupet e punës të EİPO-s dhe të Organizatës Euro[iane të Patentave. Ajo gjithashtu është përfshirë në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rajonal.

5- Promovimi i të drejtave të Pronësisë Industriale.

Me mbështetjen e projektit IPA 2009 po përgatitet një fushatë ndërgjegjësimi për publikun e gjerë lidhur me mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale.

DPPM ka përgatitur një program edukimi dhe ndërgjegjësimi për biznesin dhe materiale mbështetëse promovuese.

-Në datat 17-18 Shtator 2012, DPPM ka organizuar në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, seminarin “Pronësia Intelektuale për biznesin e vogël dhe të mesëm”.

Në kuadër të Projektit IPA 2009 janë zhvilluar aktivitete promovuese për biznesin në kuadër të panairit të biznesit zhvilluar në datat 27-29 nëntor 2012 në Tiranë.

Është planifikuar krijimi i Qendrës së Informacionit Shkencor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të PI vecanërisht për patentat e shpikjeve. Për këtë qëllim është hartuar draft-marrëveshja e bashkëpunimit mes DPPM dhe Universitetit Politeknik të Tiranës dhe po diskutohet për nënshkrimin e saj mes dy palëve. Kjo marrëveshje ka si qëllim kryesor krijimin e Qendrës së Informacionit Teknik dhe Shkencor brenda këtij universiteti.

ZHVILLIME TE TJERA

- **Asistenca financiare e Bashkimit Evropian për Pronësinë Industriale:**

Projekti ka si objektiv të përgjithshëm harmonizimin e sistemit rregullator në fushën e Pronësisë Industriale me *acquis communautaire* dhe si objektiv specifik forcimin e kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare të përfshira në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale.

Titulli i programit : “Zhvillimi i sistemit të të Drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri”;

Titulli i Projekti: IPA Kombëtare 2009

Kosto totale: EUR 1,099,915;

Kohëzgjatja e projektit: 24 muaj.

1. Institucioni ose institucionet përfituese

Ministria e Ekonomisë , Tregtisë dhe Energjetikës/ Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

2. Qëllimi dhe komponentët/aktivitetet e projektit.

Komponentët e projektit janë:

- A. Forcimi i kapaciteteve administrative të DPPM.
- B. Harmonizimi i legjislacionit shqiptar në fushën e pronësisë industriale me acquis.
- C. Forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve të përfshira në zbatimin e të drejtave të PI.
- D. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e të drejtave të PI.

- **Vizita e Drejtorit të përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri z.Francis GURRY**

Në 15 dhe 16 Tetor 2012 Kryeministri Berisha priti një delegacion të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale OBPI (WIPO), të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i saj z. Francis Gurry.

Drejtori i Përgjithshëm i OBPI, z. Francis Gurry, pasi falënderoi Kryeministrin për mikpritjen, u shpreh se ndihej i privilegjuar që iu dha mundësia të vizitojë për herë të parë Shqipërinë, pas emërimit të tij dhe, të ketë mundësi të shohë zhvillimet shumë pozitive dhe arritjet e këtij vendi. Ai vuri në dukje se bashkëpunimi i zyrës që përfaqëson, me Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe me qeverinë shqiptare, ka qenë gjithmonë shumë i frytshëm dhe bashkëpunues. Kjo vizitë synon të thellojë më tej këtë bashkëpunim dhe të vjelë rezultate të tjera pozitive.



Kryeministri e falënderoi zotin Francis Gurry për këtë vizitë dhe theksoi edhe njëherë faktin se për qeverinë e tij, pronësia intelektuale është një fushë shumë e rëndësishme që ka një rol të madh në zhvillimin e gjithanshëm të vendit, sidomos në rrafshin ekonomik e shoqëror. Kjo është një fushë shumë e ndjeshme, të cilën qeveria shqiptare e ka trajtuar me kujdes e vëmendje të veçantë, duke draftuar e aprovuar ligje që synojnë mbrojtjen e pronësisë intelektuale, e cila prek shumë njerëz e grupe të caktuara shoqërore, si dhe zhvillimet e shpejta demokratike ekonomike.

Drejtori i Përgjithshëm i OBPI, z. Francis Gurry e përgëzoi Kryeministrin për kuadrin ligjor të ndërtuar nga qeveria shqiptare në këtë drejtim, si dhe zbatimin e tij. Ai shprehu komplimentet për strategjinë e qeverisë shqiptare në lidhje me pronësinë intelektuale 2010-2015, duke theksuar se kjo strategji adreson mekanizmat e duhur për të ndihmuar zhvillimin e vendit, për të mbështetur inovacionin, krijueshmërinë dhe inkurajon sipërmarrësit dhe të talentuarit për të bërë realitet idetë e tyre dhe për t'i mbrojtur ato.

Kryeministri Berisha theksoi se qeveria ka inkurajuar dhe do të inkurajojë inovacionin, sipërmarrjen dhe krijimtarinë, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e tyre, si elementë të rëndësishëm që i nxisin dhe i çojnë përpara këto pronësi intelektuale shumë të vjera. Bashkëpunimi i qeverisë sime dhe i drejtorisë përkatëse me OBPI-n është shumë i rëndësishëm për ne, sepse ka një rol të veçantë në nxitjen dhe mbrojtjen e faktorëve që çojnë përpara zhvillimet demokratike dhe parandalon praktikat jo korrekte dhe jo ligjore që shfaqen jo rrallë.

Drejtori i Përgjithshëm i OBPI, z. Francis Gurry theksoi se kjo është një çështje delikate dhe e vështirë për t'u adresuar në mbarë botën, sepse pronësia intelektuale, duke qenë abstrakte, mbart me vete një sërë problemesh në të kuptuar e respektuar, prandaj qëllimi i organizatës është të mbështesë të gjitha ato zhvillime të lidhura me revolucionin dixhital, demokratizimin e njohurive që mundësojnë të ushtruarit e të drejtave të kësaj pronësie dhe mbrojtjes së saj. Ai

tha se Shqipëria shquhet dhe përgëzohet për arritjet e saj në vitet e fundit, në mbështetjen dhe përhapjen e inovacionit në procesin e edukimit dhe arsimimit. Këto arritje duhen zhvilluar më tej, me të njëjtat ritme dhe përkushtimin e deritanishëm.

Ai zhvilloi takime dhe me kryetaren e parlamentit znj. Jozefina TOPALLI.

Në këto takime drejtori I përgjithshëm I OBPI shoqërohej nga Drejtori I përgjithshëm I DPPM z. Safet SULA si dhe nga përfaqësuesi jone zyrën e Kombeve të bashkuara në Gjenevë z. Sejdi Qerimaj.

- **Përfaqësuesit e autorizuar të objekteve të PI**


Në mbështetje me ligjin 9947 “Për Pronësinë Industriale”, Kapitulli XXXIV “Përfaqësimi”, Neni 195 - 198, Drejtorja ka organizuar testime me qëllim liçensimitin e ekspertëve që do të punojnë në fushën e Pronësisë Industriale si përfaqësues të autorizuar të patentave, disenjove industriale, markave tregtare dhe të shërbimit dhe treguesve gjeografikë. Qëllimi i këtyre testeve ka qenë verifikimi i nivelit të njohurive teorike dhe praktike, i nivelit të njohurive në fushën e legjislacionit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi dhe përdorimi i këtyre njohurive në praktikë, gjë kjo shumë e nevojshme për të parë performancën e punës së tyre si përfaqësues të autorizuar. Testimet janë organizuar mbështetur në kërkesat e ligjit 9947 “Për Pronësinë Industriale” dhe rregullores dalë në zbatim të tij. Gjatë vitit 2012 janë marrë në testim 12 persona.

II. DETYRAT FUNKSIONALE SIPAS SEKTOREVE

1. SEKTORI I EKZAMINIMIT TE PATENTAVE DHE MODELEVE TE PERDORIMIT.

Sektori i ekzaminimit të patentave dhe modeleve të përdorimit ka mbuluar të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë e cila ka të bëjë me regjistrimin dhe administrimin e patentave të shpikjeve dhe modeleve të përdorimit. Nga ky sektor kryhen hetime sipas kërkesave të aplikuesve për të gjitha aplikimet për patenta .

Për patentat e shpikjeve në vitin 2012 janë depozituar **352** aplikime te reja për patentë, nga të cilat **343** kanë qenë kërkesa për shtrirje të Patentave Europiane, **6** aplikime për Patenta Kombëtare, dhe **3** aplikime PCT. Gjithashtu gjatë këtij viti zyra ka funksionuar si zyrë përcjellëse për në EİPO.



Grafiku i mësipërm tregon numrin e aplikimeve për patentë shpikje të depozituar në DPPM nga viti 1993 deri në 2012.

Gjatë vitit 2011 janë lëshuar **339** dëshmi depozitim, janë lëshuar **55** njoftime për plotësim formalitetesh të aplikimeve për patenta, nga të cilat: **7** janë refuzuar për mosplotësim të dokumentacionit në afatin e caktuar. Gjithashtu janë lëshuar **351** patenta për shpikje nga të cilat **344** janë patenta Evropiane dhe **7** janë patenta kombetare .

Janë egzaminuar dhe pranuar **1909** ripërtëritje patentash nga **1759** që janë ripërtëritje në vitin e kaluar vitin e kaluar, ndërsa **9** patenta patenta janë egzaminuar dhe u është dhënë statusi skaduar për arsye të mospagesës së tarifës përkatëse për ripërtëritje të patentës.

Gjithashtu janë shqyrtuar **9** raste për rivendosje në afat të patentave /aplikimeve për patente nga te cilat janë rivendosur në afat **7** prej tyre dhe **2** janë refuzuar.

Në vitin 2012 numri i aplikimeve të depozituara për egzaminim në sektorin e patentave ka qenë në total **2649** nga **2461** aplikime që ishin në vitin **2011** të cilat janë paraqitur në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme :

APLIKIME TE DEPOZITUARA NE DPPM PER EGZAMINIM NE SEKTORIN E PATENAVE

Aplikime per patente shpikje	352
Aplikime per model perdorimi	0

Aplikime për ripërtëritje patente	1983
Aplikime për ndryshim pronësie	44
Aplikime për ndryshim emri	67
Aplikime për ndryshim adrese	68
Aplikime për ndryshime në pretendime	16
Aplikime për çertifikate të mbrojtjes shtesë	5
Hetime patente	105
Aplikime për rivendosje në afat	9
Totali	2649

Gjate këtij viti është përballuar një volum i madh i pune nga **3116** veprime të kryera nga sektori në vitin 2011 në **3656** veprime për vitin 2012, dhe është pare një angazhim i madh nga ana e stafit për realizimin e detyrave të mara përsipër vitin e kaluar duke i realizuar ato plotësisht.

Tabela e mëposhtme jep në mënyrë më të detajuar dokumentat e leshuara nga sektori i patentave

Dokumenta të Lëshuara nga Sektori i Patentave	NR
Dëshmi depozitimi	339
Njoftime në file examination	2
Njoftim për plotësim formalitetesh	53
Ftesë për pagesë për lëshimin e patentës	7
Ndryshim Emri	43
Ndryshim Adrese	65
Ndryshim Pronari	20
Ndryshime në pretendime	12
Njoftim për ripërtëritje patente	1909
Patenta Europiane të Lëshuara	344
Patenta PCT dhe kombetare	7
Dorëheqje patentash	0
Refuzim në file exam	0
Refuzime për mospagesë reg	0
Refuzim në examimin formal	7
Pavlefshmëri e patentës për mospagesë të mbajtjes në fuqi	9
Njoftim hetimi për patentë	96
Dublikatë patente	0
Ekstrakt Patente	5
Certifikata të mbrojtjes shtese	0
Rikthim në afat të të drejtave të patentës	7
Refuzim i kërkesës për rikthim në afat të të drejtave të patentës	2
Njoftim plotësim doc. për ripërtëritje patente	11
Firmosje në IPAS	718
Totali	3656

Gjatë këtij viti kemi arritur të minimizojmë kohën për shtrirjen e Patentave Europiane nga 4 muaj ne 1 muaj duke zbatuar njëkohësisht te gjitha procedurat administrative për lëshimin e patentave, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbim të shpejtë për të gjithë aplikantët gjatë procesit të egzaminimit.


Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon fluksin e aplikimeve kryesore që kanë hyrë dhe kanë dalë nga sektori i patentave gjatë këtij viti.

Aplikime për Patenta	Hyrje ne DPPM	Dalje nga DPPM
Viti	2012	2012
Aplikime për patentë	352	351
Ndryshim pronësie /emri/adrese	179	128
Ndryshim ne pretendime	12	16
Aplikime per ripertëritje	1983	1909
Hetim patente	105	96

Regjistrat e objekteve të pronësisë industriale për sektorin janë azhornuar përkatësisht me 2388 fletë regjistri, janë vendosur fletët e regjistrit për 128 ndryshime emri, ndryshime adrese dhe ndryshime pronësie, janë vendosur fletët e regjistrit të 1909 ripërtëritjeve, për 351 çertifikata regjistrimi.

	Aplikime për patenta	Patenta të lëshuara
2000	63	6
2001	120	49
2002	238	87
2003	392	201
2004	420	390
2005	386	395
2006	426	116
2007	367	420
2008	377	541
2009	361	402
2010	341	348
2011	354	439
2012	352	351

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve për patenta dhe patentat e lëshuara në vitet 2000-2012



Gjatë vitit 2012 nga ky sektor është punuar dhe në drejtime të tjera si:

- 1- Sektori ka bashkepunuar me Zyrën Europiane të Patentave dhe Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale në raportimin rregullisht të statistikave dhe plotësimin në kohë të pyetësorëve të kërkuara për patentat e shpikjeve.
- 2- Paisja me bazë materiale dhe logjistike e Sektorit të Patentave
- 3- Stafi i sektorit ka marrë pjesë në takime si edhe në trajnime të organizuara nga EPO.


2. SEKTORI I EKZAMINIMIT TE MARKAVE TREGTARE DHE TE SHERBIMIT, DIZENJOVE INDUSTRIALE DHE TREGUESEVE GJEORAFIKE

Sektori i ekzaminimit të markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë ka si detyrë funksionale regjistrimin e aplikimeve të objekteve të Pronësisë Industriale si markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë. Nga ky sektor janë lëshuar të gjitha ekstraktet e regjistrimit dhe janë kryer hetime sipas kërkesave të aplikuesve për të gjitha objektet e PI të lartpërmendura. Sektori i ekzaminimit të markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë në vitin 2012 ka përballuar një volum të madh pune.

Gjatë vitit 2012 janë lëshuar **1036** çertifikata regjistrimi dhe ripërtëritje marke nga 934 çertifikata regjistrimi dhe ripërtëritje marke të lëshuara në vitin 2011. Nga këto çertifikata **314** janë çertifikata ripërtëritje marke të lëshuara në vitin 2012, nga 367 çertifikata ripërtëritje marke të lëshuara në vitin 2011.

Pra nga **722** çertifikata regjistrimi marke të lëshuara në total në vitin 2012, **461** janë çertifikata regjistrimi lëshuar për marka me pronarë të huaj dhe **261** janë çertifikata regjistrimi lëshuar për marka me pronarë shqiptarë.

Certifikata regjistrimi të lëshuara	VITI 2012
Certifikata regjistrimi për aplikantë shqiptare	261
Certifikata regjistrimi për aplikantë te huaj	461
TOTALI	722




Në vitin 2012 janë depozituar 1017 aplikime për marka nga 1057 aplikime të depozituara në vitin 2011. Nga këto aplikime 331 janë ripërtëritje marke të depozituara në vitin 2012 nga 337 aplikime për ripërtëritje marke të depozituara në vitin 2011.


Nga të dhënat e lartpërmendura del se gjatë vitit 2012 sektori ka lëshuar 102 certifikata më shumë se në vitin 2011 e shprehur në përqindje 9.8% më shumë në 2012 se në vitin 2011, ndërsa në vitin 2012 janë regjistruar 40 aplikime me pak se në vitin 2011 ose 3.93%.

Sic shihet në vitin 2012 kemi një rritje të numrit të certifikatave të regjistrimit të lëshuara që tregon se gjatë këtij viti është përballuar një volum më i madh pune.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i aplikimeve, regjistrimeve dhe ripërtëritjeve në vite.



Nëse do të krahasojmë numrin e aplikimeve me numrin e regjistrimeve të kryera gjatë vitit 2012 aplikimet zënë (50%) dhe regjistrimet (50%).




Nga sektori i markave gjatë vitit 2012 janë lëshuar: 731 dëshmi depozitimi dhe janë publikuar; për 239 aplikime janë lëshuar njoftime për plotësim defektsh dhe formalitetesh, 739 ftesa për pagesë regjistrimi, janë ekzaminuar 129 aplikime për ndryshime në pronësi dhe 221 ndryshime në emër dhe adresë, janë lëshuar 722 çertifikata regjistrimi, 314 çertifikata regjistrimi ripërtëritje, 8 refuzime për moskryerje pagese regjistrimi, 13 refuzime nga ekzaminimi formal, 12 refuzime për shkaqe absolute, 6 kufizime të listës së mallrave, 7 dorëheqje nga marka dhe 9 kontrata licence marka.

Në total gjatë vitit 2012 nga ky sektor janë lëshuar 5423 dokumenta.

Dokumenta të lëshuara në vitin 2012	Nr. dokumentave
Deshmi depozitimi	731
Njoftim plot form	239
Ftesë për pagesë reg	739
Certif. Reg	722
Ripërtëritje marke	314
Ndryshim Ermri/adrese	221
Ndryshim Pronari	129
Refuzime për mospagesë reg	8
Refuzim ne form exam	13
Refuzim ne baza absolute	12
Kufizim I listës së mallrave	6
Doreheqje nga marka	7
Dublikata	30
Hetim marke	212
Ekstrakt Regjistri	189
Njoftim plotesim defektesh disenjo industriale	14
Deshmi depozitimi disenjo	14
Certifikata regjistrim/riperteritje disenjo	13
Refuzim disenjo	6
Licenca marke	9
Riperteritje disenjo	7
Ndryshim adrese pronarit	3
Ekstrakt regjistri disenjo industriale	1
Veprime te firmosjes ne IPAS	1755
TOTALI I DOKUMENTAVE TË LËSHUARA	5423

Volumi më i madh i punës së këtij sektori është realizuar në drejtim të lëshimit të certifikatave të regjistrimit, lëshimit të certifikatave të ripërtëritjes, lëshimit të dëshmimeve të depozitimit dhe dokumentave të lëshuara për ndryshim pronësie, adrese dhe emri. Grafiku i mëposhtëm tregon një pjesë të dokumentave të lëshuara gjatë procesit të ekzaminimit në vitin 2012.



Shih shihet gjatë vitit 2012 numri i njoftimeve për plotësim formalitetesh ka ardhur duke rënë. Plotësimi i saktë i dokumentacionit ndikon në eliminimin e lëshimit të njoftimeve për plotësim dokumentacioni, duke shpjeguar në këtë mënyrë procedurat për lëshimin e Çertifikatës së regjistrimit.

Gjatë këtij viti jemi përpjekur të minimizojmë kohën për zbatimin e procedurave administrative për markat, duke zbatuar me rigorozitet afatet ligjore. Qëllimi kryesor i punës është të sigurojmë cilësi të lartë dhe shërbime të shpejta për të gjithë aplikantët gjatë procesit të egzaminimit.

Në tabelën e mëposhtme jepen dokumentat e depozituara në DPPM gjatë vitit 2012

DOKUMENTA TE DEPOZITUARA NE DPPM

Kërkesa për regjistrim marke	686
Kërkesa për ripërtëritje marke	331
Kërkesa për ndryshim i emrit te pronarit	130
Kërkesa për ndryshimin e adresës se pronarit	156
Kërkesë për kufizim të listës së mallrave	10
Kërkesa për ndryshim pronari	197
Kërkesë për ekstrakt regjistri	228
Kërkesë për doreheqje marke	8
Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të markes	30
Kërkesë për licencë	9
Kërkesë për ripërtëritje diseno	5
Kërkesë për dublikatë certifikate	18
Kërkesë ndryshim emri/adrese diseno	2
Kërkesë për disenoje	25
Kërkesë për hetim marke	229
Totali	2064

Regjistrat e objekteve të pronësisë industriale për sektorin janë azhornuar përkatesisht me 1415 fletë regjistri, janë vendosur fletët e regjistrit për 350 ndryshime emri, ndryshime adrese dhe ndryshime pronësie, janë vendosur fletët e regjistrit të 314 ripërtëritjeve, për 722 çertifikata regjistrimi, kufizim liste mallrash 6 aplikime, 20 diseno dhe 3 ndryshime adrese pronari, si dhe janë marre ne dorëzim 1372 dosje markash dhe 2424 dosje patentash.

Gjatë vitit 2012 i është dhënë përgjigje 212 kërkesave për hetim marke përfshirë këtu (hetim në regjistrat kombëtare dhe ndërkombëtare), janë lëshuar 189 ekstrakte regjistri dhe 13 dublikata marke.

Aplikimet nga Marrëveshja e Madridit

Gjatë vitit 2012 janë rregjistruar 3832 aplikime nga Marrëveshja e Madridit nga të cilat 1242 janë aplikime per ripërtëritje markash.

Ne total në DPPM në vitin 2012 janë depozituar 4849 aplikime dhe ripërtëritje nga të cilat 3832 nga Marrëveshja e Madridit, 735 aplikime të huaja dhe 282 aplikime shqiptare.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve vendase, aplikimeve në rrugë kombëtare dhe aplikimeve nga Marrëveshja e Madridit, gjatë vitit 2012.

APLIKIME	VITI 2012
Aplikime shqiptare	282
Aplikime ne rruge kombëtare nga aplikante te huaj	735
Aplikime nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit	3832
TOTALI	4849





Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon se në vitin 2012 kemi një rritje të lehtë të numrit të aplikimeve shqiptare në krahasim me aplikimet e bëra në vitin 2011. Gjithashtu në vitin 2012 kemi një rënie të aplikimeve në rrugë kombëtare nga aplikantë të huaj dhe aplikimeve të ardhura nga Marrëveshja e Madridit.

APLIKIME	2011	2012
Aplikime shqiptare/Riperteritje	276	282
Aplikime ne rruge kombëtare nga aplikante te huaj/Riperteritje	781	735
Aplikime nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit/Riperteritje	3973	3832
TOTALI	5030	4849



Nga ky sektor janë hedhur në IPAS veprimet e firmosjes për 1755 aplikime kombëtare.


Gjatë vitit 2012 janë lëshuar 13 certifikata regjistrimi disenjosh industriale, 7 ripërtëritje disenjosh, 14 dëshmi depozitimi, 14 njoftime plotësim dokumentacioni, është bërë 6 refuzim disenjoje si dhe janë ekzaminuar dhe janë lëshuar 3 ndryshime të adresës së pronarit.

DISENJOT INDUSTRIALE

Në vitin 2012 janë depozituar 25 kërkesa për regjistrim disenjoje dhe 5 kërkesa për ripërtëritje disenjoje si dhe 2 kërkesa për ndryshim emri/adrese të pronarit të disenjos.

Pra kemi një rritje të numrit të disenjove të depozituara në vitin 2012 në krahasim me numrin e disenjove të depozituara në vitin 2011.

APLIKIME DISENJO INDUSTRIALE	2011	2012
APLIKIME	6	25
TOTALI	6	25



Gjate vitit 2012 nga ky sektor është punuar dhe në drejtime të tjera si:

- 1- Janë hartuar janë hartuar raportet 6- mujore dhe vjetore të punës si dhe progres raporti mbi zbatimin e strategjisë Kombëtare të PI.
- 2- Përfaqësues të këtij sektori kanë përfaqësuar DPPM në seminare të ndryshme ku dhe kanë diskutuar mbi legjislacionin e ri të DPPM-së, mbi markat dhe rëndësinë e tyre për ekonominë e tjerë.
- 3- Stafi i sektorit ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me EİPO dhe EPO.
- 4- Përfaqësues të sektorit kanë bashkëpunuar me sektorin juridik dhe ekspertët e projektit IPA për finalizimin e projektligjeve për disa ndryshime në ligjin “Për Pronësinë Industriale“ dhe ligjin “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara“ dhe konsultimin e tyre me grupet e interesit.
- 5- Gjatë muajit Nëntor- Dhjetor 2012 në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015 është ndjekur korrespondenca me institucionet e përfshira në planin e veprimit të Strategjisë dhe është përgatitur progres raporti për vitin 2011 dhe janë mbledhur materialet për vitin 2012.

3- SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Sektori Juridik, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve ka si objekt kryesor të veprimtarisë së tij: të sigurojë që praktikat e punës së sektorëve të tjerë të drejtorisë të jenë në

përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryesisht nga Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008, aktet nënligjore dalë në zbatim të tij dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale; të përgatisë praktikën për miratimin ose ndryshimet në aktet ligjore, nënligjore ose aktet e brendshme të drejtorisë, të cilat rregullojnë veprimtarinë funksionale të Drejtorisë; të mbajë korrespondencën me zyrat ndërkombëtare dhe institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat bashkëpunon Drejtoria në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të fushës si dhe nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Spektori Juridik i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve gjatë vitit 2012, në përmbushje të aktivitetit të tij funksional, ka punuar në këto drejtime kryesore:

A. Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga MSA dhe përmirësimi i legjislacionit

Spektori Juridik i DPPM, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, ka ndjekur dhe përmbushur detyrat e mëposhtme:

1. Raportimi i përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga MSA:

a) Përgatitja e raportit të kontributit të qeverisë shqiptare në hartimin e progres raportit të BE për Shqipërinë për vitin 2011, kapitulli 7 (Pronësia Intelektuale) si dhe hartimi i progres-raporteve periodike për Komisionin Evropian, Komitetin e Stabilizim Asociimit dhe takimin e Nënkomitetit BE-Shqipëri për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën (Prill 2012) në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër në MSA, Dokumentin e Partneritetit dhe PKZMSA në fushën e të drejtave të Pronësisë Industriale dhe që shërbejnë si bazë për përgatitjen e Progres Raportit të BE për Shqipërinë.

b) Përgatitja e komenteve dhe sqarimeve lidhur me gjetjet e Raportit Analitik 2011 dhe Progres Raportin 2012 të BE për Shqipërinë në lidhje me Kapitullin 7 (Pronësia Intelektuale) dhe raportimi i tyre pranë METE.

c) Hartimi i Planit Kombëtar për zbatimin e MSA 2012-2015 për Kapitullin 7, pronësia industriale, dhe raportimi periodik për zbatimin e tij në rrugë shkresore dhe në sistemin elektronik.

2. Hartimi i akteve ligjore me qëllim përmirësimin e legjislacionit

2) Përcaktimi i akteve komunitare në fushën e pronësisë industriale që janë relevante për përafrim në legjislacionin kombëtar dhe ndarja e acquis në sistemin elektronik të akteve komunitare.

- 3) Përgatitja e praktikës për miratimin e marrëveshjes së Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës Evropiane të Patentave.
- 4) Përgatitja e praktikës për miratimin e një ndryshimi në VKM Nr. 636 datë 19.09.2012 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2010-2015”.
- 5) Hartimi i tablave të përfrimit të ligjit “Për Pronësinë Industriale” dhe ligjit “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” me aktet komunitare të fushës dhe venia e tyre në dispozicion të ekspertëve të projektit IPA për hartimin e ndryshimeve në këto ligje me qëllim përfrimin e plotë me acquis.
- 6) Bashkëpunimi me ekspertët e projektit IPA për finalizimin e projektligjeve për disa ndryshime në ligjin “Për Pronësinë Industriale” dhe ligjin “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” dhe konsultimin e tyre me grupet e interesit.
- 7) Hartimi i ndryshimeve në rregulloren e brendshme të DPPM si rezultat i ndryshimit të strukturës dhe organikës së saj, me Urdhrin Nr. 131 datë 06.11.2012 të Kryeministrit.

3. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale

- a) Mbajtja e korrespondencës me institucionet e përfshira në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015 dhe përgatitja e informacioneve dhe raportimeve për iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të ndërmarra nga DPPM në zbatim të kësaj Strategjie.
- b) Organizimi i takimit të Grupit Ndër-Institucional të monitorimit të Strategjisë, mbajtja e minutave të takimit dhe dhënia e informacionit të takimit për institucionet e interesuara.
- c) Pjesëmarrja dhe dhënia e kontributit në takimet e grupit të punës për krijimin e Inspektoriatit të Mbikqyrjes së Tregut pranë METE për pjesën që i takon inspektimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale.
- d) Hartimi i projekt-marrëveshjes së bashkëpunimit mes DPPM dhe Universitetit Politeknik të Tiranës për krijimin e Qendrës së Informacionit Teknik dhe Shkencor. Marrëveshja pritet të nënshkruhet dhe hyjë në fuqi gjatë vitit 2013.
- e) Pjesëmarrja në takimet trajnuese të organizuara nga projekti IPA 2009 me përfaqësues të gjykatës dhe Shkollës së Magjistraturës dhe prezantimi i praktikave të mbrojtjes administrative të të drejtave të Pronësisë Industriale.

4. Detyra të tjera

- a) Mbajtja e kontakteve dhe dhënia e mbështetjes dhe informacioneve të kërkuara nga grupi i zbatimit të projektit IPA Kombëtare 2009 si dhe përgatitja e raporteve lidhur me zbatimin e projektit, të kërkuara nga METE.

- b) Dhënia e asistencës juridike për Sektorët e Ekzaminimit të Patentave dhe Markave për interpretimin dhe zbatimin e saktë të ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të cilat bazohet veprimtaria e tyre.
- c) Përpilimi i shkresave dhe informacioneve të ndryshme gjatë procesit të këmbimit të korrespondencës me subjekte private apo institucione shtetërore për çështje me karakter juridik.
- d) Përgatitja e raportit vjetor 2011 dhe e objektivave të Sektorit për vitin 2012.
- e) Kryerja në IPAS e veprimeve lidhur me aplikimet ndërkombëtare për regjistrimin e markave në bazë të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit;
- f) Shpërndarja e korrespondencës së DPPM me institucionet e tjera kombëtare, ndërkombëtare dhe me subjektet që aplikojnë pranë DPPM për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale.

B. Përfaqësimi i DPPM në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2012, sektori juridik ka ndjekur **26 çështje gjyqësore** pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilat DPPM është thirrur si palë e paditur ose person i tretë, nga të cilat:

- **7** çështje kanë pasur si objekt shfuqizimin e një marke të regjistruar, për arsye të cënimit të të drejtave të një marke të mëparshme ;
- **16** çështje kanë pasur si objekt apelimin e një vendimi të Bordit të Apelit të marrë lidhur me kërkesën për kundërshtimin e regjistrimit të një marke të publikuar për shkak të shkëljes së të drejtave të mëparshme (15 çështje) dhe lidhur me kërkesën për rivendosjen në afat të një patente (1 çështje);
- **1** çështje ka pasur si objekt pushimin e cënimit të të drejtave të pronësisë industriale dhe dhënien e dëmshërblimit.
- **1** çështje ka pasur si objekt shpalljen e pavlefshmërisë së patentës.

Gykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2012 ka marrë vendim për **11** çështje me palë DPPM, duke vendosur :

- për **3** nga çështjet me objekt shfuqizimin e një marke të regjistruar, pranimin e padisë dhe cregjistrimin e markës në të gjitha rastet;
- për **7** nga çështjet me objekt apelimin e një vendimi të Bordit të Apelit të DPPM, rrëzimin e padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të Bordit në 3 raste, pushimin e padisë për shkak të heqjes dorë të paditësit në 4 raste.
- për **1** çështje me objekt pushimin e cënimit të të drejtave mbi një tregues gjeografik dhe pagimin e dëmit, gjykata ka vendosur pranimin e padisë.

Gjatë vitit 2012, sektori juridik ka ndjekur **3 çështje gjyqësore** pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, me objekt shfuqizimin e markës tregtare, në përfundim të të cilave gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

C. Mbajtja e korrespondencës me Zyrën Ndërkombëtare të OBPI

Gjatë vitit 2012 janë dërguar pranë Zyrës Ndërkombëtare të OBPI, aktet e parashikuara nga Marrëveshja/Protokolli i Madridit lidhur me regjistrimet ndërkombëtare të markave si më poshtë:

- Njoftimi për refuzimin e plotë provizor për shkak të paraqitjes së një kundërshtimi për **9** regjistrime ndërkombëtare;
- Njoftimi për refuzimin provizor për shkaqe absolute për refuzim për **3** regjistrime ndërkombëtare;
- Njoftimi për konfirmimin e refuzimit të plotë provizor për **3** regjistrime ndërkombëtare;
- Njoftimi i tërheqjes së refuzimit të plotë provizor për **2** regjistrime ndërkombëtare;
- Kërkesa për regjistrimin ndërkombëtar të një marke të regjistruar në Shqipëri (**2** marka).

D. Ndjekja e procedurave dhe përpilimi i akteve ligjore për kërkesat e paraqitura pranë Bordit të Apelit të DPPM .

Gjatë vitit 2012, Sektori Juridik ka ndjekur procedurat dhe ka përgatitur njoftimet dhe aktet e tjera ligjore për **41 kërkesa** të paraqitura pranë Bordit të Apelit të DPPM (30 kërkesa të reja të paraqitura gjatë vitit 2012 dhe 11 kërkesa të mbartura nga viti 2011) sipas këtyre objekteve:

1. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave kombëtare

Gjatë vitit 2012, pranë Bordit të Apelit të DPPM janë depozituar **18** kërkesa të reja për kundërshtimin e një aplikimi kombëtar për regjistrim marke dhe 6 çështje janë mbartur nga viti 2011.

Bordi i Apelit ka marrë vendim për **20** çështje duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **5** raste;
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës në **10** raste
- mospranimin për shqyrtim të kërkesës në **2** raste.
- pushimin e shqyrtimit për shkak të dorëheqjes nga marka ose nga kërkesa për kundërshtim, në **3** raste.

8 prej vendimeve të Bordit janë apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave ndërkombëtare

Gjatë vitit 2012 janë depozituar pranë Bordit të Apelimit të DPPM, **10** kërkesa të reja për kundërshtimin e një aplikimi ndërkombëtar për regjistrim marke, të publikuar në Buletinin e Markave të Zyrës Ndërkombëtare të OBPI (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale) në bazë të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit dhe **6** çështje të tilla janë mbartur nga viti 2011.

Bordi i Apelimit ka marrë vendim për **10** çështje duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **6** raste;
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës për **2** raste.
- mospranimin për shqyrtim të kërkesës në **2** raste.

Asnjë prej vendimeve të mësipërme të Bordit nuk është apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Kërkesa për apelimin e vendimit të DPPM për refuzimin e një aplikimi

Bordi i Apelimit të DPPM, përveç kërkesave për kundërshtimin e regjistrimit të markave, disenjove industriale dhe patentave të lëshuara, shqyrton edhe kërkesat për apelimin e vendimeve të marra nga Sektorët e DPPM që shqyrtojnë kërkesat për lëshim patente apo për regjistrimin e markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë.

Gjatë vitit 2012, pranë Bordit të Apelimit të DPPM është paraqitur vetëm **1** kërkesë apeli, konkretisht, apeli i vendimit të sektorit të patentave për mospranimin e rivendosjes së të drejtave mbi një patentë evropiane të skaduar.

Bordi ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të sektorit të patentave dhe ky vendim është apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4-SEKTORI TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT

Një detyrë kryesore IT është edhe administrimi i sistemit të automatizimit të Pronësisë Industriale (IPAS).

Në Janar 2012 sistemi u konfigurua për procedimin e të gjithë vitit 2012, për arsye se sistemi funksionon me procedime vjetore, ku çdo ditë punë e vitit ka veprimet e bëra në këtë ditë.

Një element shumë i rëndësishëm gjatë vitit 2012 ka qënë instalimi i versionit të ri IPAS Java ne Qershor 2012, kohe ne te cilen DPPM kaloi perfundimisht nga perdorimi i versionit te vjeter te IPAS ne te versionin e ri. Në Gusht 2012, eksperti i ËIPO-s realizoi nje mision ne DPPM per vleresimin e versionit te ri te instaluar ne DPPM. Pas perfundimit te misionit, ne periudhen

Shtator –Dhjetor 2012, u instalua disa here perditesime te IPAS Java, ne varesi te ndryshimeve te ofruara nga EİPO.

Në muajt Qershor – Dhjetor, në mënyrë të vazhdueshme nga sektori i TI është bërë trajnimi i stafit për përdorimin e IPAS Java.

Detyrat e realizuara për funksionimin e IPAS gjatë 2012:

- Back-up i përditshëm për sigurinë e ruajtjes së informacionit.
- Ndryshime te konfigurimit apo dokumentave te lëshuara nga DPPM ne varesi te kerkesave te ndryshimeve ligjore.
- Gjenerimi i statistikave të ndryshme gjatë 2012.
- Administrimi i të drejtave të secilit përdorues në përputhje më profilin e punës.
- Kalimi në IPAS i të dhënave bibliografike për 686 aplikime për marka, 351 aplikime për patenta, 25 aplikime për disenjo industriale.
- Janë skanuar elementet figurative të markave dhe dizenjove industriale.

Nga sektori i TI në 2012 është bërë kontroll i përditshëm i sistemit të IT së DPPM i cili ka konsistuar në:

1. Administrim i rrjetit kompjuterik (LAN) dhe siguria e funksionim të këtij rrjeti dhe pajisjeve të instaluar në të.
2. U instaluan dhe u konfiguruan dy servera te rinj, nje sëitch dhe nje fireëall.
3. Pas instalimit nga te paisjes fizike per kompjuterat e rinj nga kompania nga e cila u blene keto paisje, u instaluan te gjitha programet e domosdoshme per punen e stafit te DPPM.
4. Përditësim i faqes së internetit eëë.alpto.gov.al në varësi të informacioneve të dërguara nga sektorët përkatës.
5. Ndihmë e stafit në përdorimin e bazës së të dhënave, dhe programeve të ndryshme në funksion të punës.

PUBLIKIMI I BULETINIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE :

Në vitin 2012 janë publikuar 3249 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale të ndara në buletinë si më poshtë.

Buletini i Pronësisë Industriale(Marka) Nr.6/2012/ Dt.04 Dhjetor 2012

459 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Marka) Nr.5/2012/ Dt.01 Tetor 2012
241 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Marka) Nr.4/2012/ Dt.01 Gusht 2012
301 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Marka) Nr.3/2012/ Dt.04 Qershor 2012
502 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Marka) Nr.2/2012/ Dt.11 Prill 2012
473 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Marka) Nr.1/2012/ Dt.31 Janar 2012
405 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 12/2012/ Dt. 03 Dhjetor 2012
90 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 11/2012/ Dt. 01 Nëntor 2012
93 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 10/2012/ Dt. 01 Tetor 2012
15 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 9/2012/ Dt. 03 Shtator 2012
82 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 8/2012/ Dt. 01 Gusht 2012
118 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 7/2012/ Dt. 02 Korrik 2012
17 rekorde te publikuara

Buletini i Pronësisë Industriale(Patenta) 6/2012/ Dt. 01 Qershor 2012

120 rekorde te publikuara

Buletini i Pronesisë Industriale(Patenta) 5/2012/ Dt. 02 Maj 2012

49 rekorde te publikuara

Buletini i Pronesisë Industriale(Patenta) 4/2012/ Dt. 02 Prill 2012

51 rekorde te publikuara

Buletini i Pronesisë Industriale(Patenta) 3/2012/ Dt. 01 Mars 2012

67 rekorde te publikuara

Buletini i Pronesisë Industriale(Patenta) 2/2012/ Dt. 06 Shkurt2012

124 rekorde te publikuara

Buletini i Pronesisë Industriale(Patenta) 1/2012/ Dt. 04 Janar 2012

42 rekorde te publikuara

Për përgatitjen e statistikave dhe raporteve jane realizuar detyrat si më poshtë:

- Përgatitja raportit vjetor 2012 për sektorin e TI. Gjenerimin nga IPAS të të dhënave të domosdoshme për raportin vjetor 2012 të sektorëve të tjerë.
- Formatimi i dokumenteve statistikore dhe dokumenteve të tjerë standarde.
- Përgatitjen e raporteve apo statistikave të ndryshme të kërkuara nga eprori.
- Përgjigje kërkesa të ndryshme të depozituara në DPPM të cilat kanë lidhje me IT, dhe të deleguara nga eprori.

Detyra të tjera ndihmëse:

- Ka marrë pjesë në takime që kanë të bëjnë me TI.
- Ka assistuar në misionin e OBPI ne lidhje me IPAS në Gusht 2012.
- Ka bere te mundur lëshimin e faturave për arkëtim.
- Ka perfaqesuar DPPM ne 1 Komitet Teknik dhe Operacional të EPO.
- Ka mare pjese ne viziten studimore te realizuar ne Croaci.
- Janë kryer të gjitha veprimet hyrje dalje me magazinën.

- Janë përgatitur përgjigje të shkresave të derguara që kanë lidhje me sektorin e IT.

5. SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE, SHERBIMEVE DHE FINANCES

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së Sektorit të Burimeve Njerezore, Finances dhe Sherbimeve përgjatë vitit kalendarik 2012 kanë ardhur në zbatim të detyrave që ka ky sektor për të përmbushur funksionin e tij brenda DPPM-se.

Keto drejtime janë:

1-Planifikimi dhe realizimi i buxhetit,

2-Bilanci,

3-Auditimi,

4-Marrdheniet me jashtë në sektorin ekonomik,

5-Organizimi i pritjeve të delegacioneve të huaja,

6-Ndjekja dhe rakordimi i të ardhurave nga EPO, OBPI si dhe nga aktiviteti kryesor i DPPM, të cilat janë pjesë e Buxhetit të shtetit.

7-Kujdesi për shlyerjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga anetaresimi në OBPI dhe në organizata të tjera nderkombetare , EPO etj,

Realizimi i buxhetit të vitit 2012 i shprehur në shifra :

I Shpenzime personeli (Paga , shperblim, fondi i veçante)

Paga, shperblime (Plan) 13.258.333 leke Fakti 13.258.333 leke Realizimi 100%

ISigurim Shoqëror dhe Shendetësor

Plan 1.791.667 lek Fakt 1.791.667 lek Realizimi 100 %

Shpenzime , sherbime të ndryshme

Plan 3.797.305 lek Fakt 3.797.305 lek Realizimi 100 %.


Investime nga buxheti

Plan 1.000.000 leke Fakt 999.200 leke Realizimi: afërsisht 100 %

Realizimi i Buxhetit në total Plan 19.847.305 leke Fakt 19.846.305 leke Realizimi 99.9 %

Të ardhurat nga aktiviteti kryesor për periudhën Janar - dhjetor 2012 arritën shumën 69.670.011 lekë. Të ardhurat dytësore nga aplikimet në EPO për periudhën 2005-2010 arrijnë shumën 376.974.000 Leke. Këto të ardhura u derdhen në buxhetin e shtetit.

DPPM ka derdhur në buxhetin të ardhura nga Marrëveshja e Madridit në shumën 27.950.000 leke. Në total në vitin 2012 DPPM ka derdhur në buxhetin e shtetit 474.594.011 leke pjesa më e madhe të të cilave janë arkëtimet nga EPO (2005-2010).



Grafiku i mësipërm tregon të ardhurat nga aktiviteti parësor i DPPM, dhe shpenzimet gjatë viteve 2001-2012.

Nga ky sektor gjatë vitit 2012 janë realizuar një sërë detyrash të tjera si:

- Eshtë hartuar regjistri i parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike.
- Ne bashkëpunim me sektorin juridik është hartuar dhe zbatuar azhenda e vizitës së presidentit të EİPO-s z. Francis GERRI.
- është organizuar e gjithë vizita e tij në takimet e ndryshme me kryeministrin, ministrin e integritimit , ministrin e ekonomise, tregtise dhe energjitikes.
- Nga ana e këtij sektori është monitoruar gjithë procesi i donacioneve (pajisje për TI dhe pajisje të tjera kompjuterike) nga projekti IPA 2009 dhe Zyra Europiane e Pa.tentave.
- Auditi i Ministrisë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ka audituar periudhën viti 2011 dhe 6- mujori i I i vitit 2012.
- Ne bashkëpunim me sektorin juridik është punuar për hartimin e strukturës dhe organikës së re të DPPM.
- Sektori ka hartuar evidencat mujore për të rakorduar me thesarin, ka hartuar raporte 3- mujore për njohjen e Ministrisë me realizimin faktit të fondit të pagave, investimeve, numrin e punonjësve etj.
- Gjithashtu sektori ka hartuar raportet 6- mujore dhe vjetore të punës së tij
- Eshtë hartuar projekt buxheti për vitin 2013.
- Më muajin dhjetor vemendja kryesore i është kushtuar realizimit 100% të fondeve buxhetore, inventarizimit e aktiveve të DPPM-së dhe si.mbyllja e llogarive vjetore.

Gjatë vitit 2012 janë depozituar në zyrën e protokollit 351 kërkesa për patentë shpikje, 686 marka të aplikuara dhe të hedhura në IPAS dhe 25 disenjo industriale. Në zyrën e protokollit janë depozituar në total 6151 dokumenta.